




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 19 qershor 2025, në mbledhjen
Soleme të Kuvendit të Komunës së Podujevës,
mandati i VII, e mbajtur për nderë të 19 qershorit
Ditës së Çlirimit të Podujevës

SHQIP / ALBANIAN

Mbledhja filloi në orën 16:15, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
Nga LVV- Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artirë Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori.
Nga LDK- Valon Demolli; Arjant Topanica; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.
Nga PDK- Bashkim Sylja.
Nga AAK- Mrika Thaqi; Arbnor Fazliu,
Të Pavarrur- Demokrat Hodolli dhe Adnan Zymeri.

MUNICIPAL ASSEMBLY

Minutes held on June 19, 2025, at the Solemn Meeting of the
Podujevo Municipal Assembly, VII term, held in honor of
June 19 - Podujevo Liberation Day

ENGLISH / ANGLISHT

The meeting began at 4:15 p.m., and was held in the meeting room of the Municipal Assembly.
The meeting was opened and chaired by Mr.Hilmi Hoxha, Chairman of the Assembly.
Present at the meeting were the members of the Podujeva Municipal Assembly:
From LVV- Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artirë Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori.
From LDK- Valon Demolli; Arjant Topanica; Ilir Koprani; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.
From PDK- Bashkim Sylja.
From AAK- Mrika Thaqi; Arbnor Fazliu,
Independent- Demokrat Hodolli and Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm ishin z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, znj. Mariqona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtoreve të Komunës, dhe atë; (Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadasit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vjora Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtim DSHPMSh; Shuaib Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirije Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE.)	Also present were Mr. Shpejtim Bulliqi, Mayor of Podujeva Municipality, Mrs. Mariqona Lahu, Deputy Mayor of the Municipality, the directors of the Municipal Directorates, and that; (Valbona Azemi-Directorate of Administration DA; Fatlum Osmani-Directorate of Budget and Finance DBF; Avni Fetahu-Directorate of Education DE; Adelinë Stublla-Directorate of Health and Social Welfare DSHW; Liridon Gashi-Directorate of Urban Planning and Environmental Protection DUPEP; Saranda Stublla-Directorate of Property, Cadastre and Geodesy DPCG; Vjora Humolli Jashanica-Directorate of Culture, Youth and Sports DCYS; Bahri Selimi-Directorate of Public Protection and Rescue Services DPPRS; Shuaib Blakçori-Directorate of Inspection DI; Lirije Hoti-Directorate of Agriculture, Forestry and Rural Development DAFRD; Vigan Salihu-Directorate of Planning and Economic Development DPED.)
Të pranishëm tjerë ishin përfaqësues dhe kryetarë të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së z. Rafet Llapashica dhe Florim Slatovci. Ish komandant dhe luftëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; z. Rustem Mustafa, z. Latif Gashi, z. Arif Muçolli dhe të tjerë. Përfaqësuesi Forcës së Sigurtisë së Kosovës. Përfaqësues të Policisë së Kosovës, z. Bashkim Bajrami - Komandant i Stacionit në Podujevë. Përfaqësues të Familjeve të Dëshmoreve dhe Herojve të Kosovës. Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës znj. Saranda Bogujevci dhe znj. Drita Pajaziti. Përfaqësues të KFOR. Prezent në mbledhje ishte edhe delegacioni prej rreth 25 përfaqësues të institucioneve të Qytetit Ames të Shtetit Iowa të SHBA-ve. Pjesëmarrës tjerë në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësues të mediatve lokale-TV Llapi, si dhe një numër i qytetarëve, dhe zyrtarëve komunalë (bashkëngjitur linku i video seancës youtube: https://www.youtube.com/watch?v=lxlIKa-bRXQ Në mbledhje është bërë përkthim i drejtpërdrejt stimulant Shqip - Anglisht dhe anasjelltas, dhe atë nga znj. Lirije Hoti.	Other present were representatives and heads of the Associations of from the KLA War, Mr. Rafet Llapashica and Florim Slatovci. Former commander and fighter of the Kosovo Liberation Army; Mr. Rustem Mustafa, Mr. Latif Gashi, Mr. Arif Muçolli and others. Representative of the Kosovo Security Force. Representative of the Kosovo Police, Mr. Bashkim Bajrami - Commander of the Station in Podujeva. Representative of the Families of Martyrs and Heroes of Kosovo. Deputy of the Assembly of the Republic of Kosovo, Ms. Saranda Bogujevci and Ms. Drita Pajaziti. Representative of KFOR. Also present at the meeting was a delegation of about 25 representatives of the institutions of the City of Ames, Iowa, USA. Other participants in this meeting were representatives of the local media-TV Llapi, as well as a number of citizens and municipal officials (attached link to the video session youtube: https://www.youtube.com/watch?v=lxlIKa-bRXQ A stimulating direct translation was made at the meeting Albanian - English and vice versa, and that by Ms. Lirije Hoti.

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit

➤ Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë - Himni Kombëtar

Kryesuesi i Kuvendit z.Hilmi Hoxha, të nderuar të pranishëm zonja dhe zotërinj, mirë se keni ardhur në këtë seancë solemne kushuar Ditës së Çlirimit të Podujevës.

Sot ne po shënojmë me krenari 26 vjetorin e çlirimit të Qytetit tonë, një datë me rëndësi të madhe për qytetarët e Llapit. Në këtë ditë të shënuar ne kujtojmë me respekt dhe përlësi të gjithë Heronjtë, Dëshmorët dhe Martirët të cilët sakrifkuan gjithëcka për lirinë tonë, andaj në shenjë të respektit për ata ju ftoj që së bashku të mbajmë 1 minutë heshtje

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë të rënëve për liri.
(Lavdi përjetësisht për të gjithë të rënë për liri)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, të nderuar mysafirë, ndihem i nderuar që sot me këtë fjalë rasti të hap zyrtarisht këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës për të shënuar këtë ditë të rëndësishme për qytetarët tanë. Kam kënaqësinë të përshëndes në mënyrë të veçantë Kryetarin e Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi, Nënkyretaren e Komunës znj.Marigonë Lahu, delegacionin e qytetit partner Ames të shtetit Iowa-SHBA, Familjet e nderuara të Dëshmoreve, Invalidë dhe Veteranë të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-UÇK, përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, Komandantin e Zonës Operative të Llapit

1.Opening of the meeting by the Chairperson of the Assembly

➤ Occasional speech by the Chairperson of the Municipal Assembly

The meeting opened with the Singing of the Anthem of the Republic of Kosovo and the Anthem of the Republic of Albania - National Anthem

Speaker of the Assembly Mr. Hilmi Hoxha, distinguished guests, ladies and gentlemen, thank you for coming to this solemn session dedicated to the Liberation Day of Podujeva.

Today we are proudly marking the 26th anniversary of the liberation of our City, a date of great importance for the citizens of Llapi. On this marked day, we remember with respect and humility all the Heroes, Martyrs and Martyrs who sacrificed everything for our freedom, therefore, as a sign of respect for them, I invite you to observe 1 minute of silence together.

A minute of silence is observed in honor of all those who fell for freedom.

(Eternal glory to all those who fell for freedom)

Mr.Hilmi Hoxha, Speaker of the Assembly, continued, continued, distinguished guests, I feel honored that today with these words I have the opportunity to officially open this solemn meeting of the Podujevo Municipal Assembly to mark this important day for our citizens. I have the pleasure of specially greeting the Mayor of Podujeva, Mr. Shpejtim Bulliqi, the Deputy Mayor of the Municipality, Ms. Marigonë Lahu, the delegation of the partner city of Ames, Iowa, USA, the honorable families of the Martyrs, Invalids and Veterans of the Kosovo Liberation Army-KLA War, the representatives of the Associations that emerged from the KLA war, the Commander of the Llapi

z. Rustem Mustafa, zotëri Latif Gashin, zotëri Arif Muçollin, anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, drejtorët e Ekzekutivit komunal, Deputetë/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të KFOR, përfaqësues të Shoqërisë Civile, Media dhe gjithë qytetarët e pranishëm. Sot jemi mbledhur këtu për të përkujtuar dhe për të nderuar një nga ditët më të rëndësishme në historinë e Qytetit dhe Komunës tonë Ditën e Çlirimit të Podujevës. Kjo Ditë nuk është vetëm një përvjetor historik por është një ditë kujtese, një ditë nderimi dhe mbi të gjitha një ditë reflektimi për rrugën që kemi kaluar si qytetarë dhe si shoqëri. Është një moment që na rikujton sakrificën e atyre që dhanë jetën për lirinë tonë, djemtë dhe vajzat që me trimërinë, guximin dhe dashurinë për atdhe u bënë simbol i qëndresës dhe lirisë. Podujeva si pjesë e pandarë e Kosovës ishte dëshmitare e vuajtjes por edhe krenarisë së madh, nga këto troje u ngritën Heronj të vërtetë që luftuan për dinjitetin dhe të ardhmen e brezave që vijnë. Ne nuk do të harrojmë kurrë kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe çdo qytetar të thjeshtë që dha gjithçka për një Kosovë të lirë. Sot, përveç nderimit kemi edhe një përgjegjësi që të ndërtojmë një Podujevë që nderon gjakun e Dëshmoreve jo vetëm me fjalë por edhe me punë, të ndërtojmë institucione të forta, të drejta dhe transparente, të punojmë për një mirëqenie më të mirë, për një arsim cilësor, për zhvillim ekonomik dhe për një të ardhme që i'u detyrohem brezave të rinj. Të nderur të pranishëm, çlirimi nuk është fundi i një rruge, është fillim i një tjetër rruge, është angazhimi ynë i përditshëm për ta bërë lirinë të ndihet në çdo cep të Komunës tonë, le ta përdorim këtë ditë për afirmimin dhe përkushtimin tonë pa ta quar përpara Komunën me një unitet, respekt dhe punë të ndershme.	Operational Zone, Mr. Rustem Mustafa, Mr. Latif Gashi, Mr. Arif Muçolli, the members of the Podujeva Municipal Assembly, the directors of the Municipal Executive, the Deputies of the Assembly of the Republic of Kosovo, representatives of the Kosovo Police, representatives of KFOR, representatives of Civil Society, the Media and all the citizens present. Today we are gathered here to commemorate and honor one of the most important days in the history of our City and Municipality, the Liberation Day of Podujeva. This Day is not only a historical anniversary but it is a day of remembrance, a day of honor and above all a day of reflection on the path we have traveled as citizens and as a society. It is a moment that reminds us of the sacrifice of those who gave their lives for our freedom, the boys and girls who, with bravery, courage and love for their homeland, became a symbol of resistance and freedom. Podujeva as an integral part of Kosovo was a witness to suffering but also great pride, from these lands arose true Heroes who fought for the dignity and future of generations to come. We will never forget the contribution of the Kosovo Liberation Army and every ordinary citizen who gave everything for a free Kosovo. Today, in addition to honoring, we also have a responsibility to build a Podujevo that honors the blood of the Martyrs not only with words but also with work, to build strong, fair and transparent institutions, to work for better welfare, for quality education, for economic development and for a future that we owe to the new generations. Honored guests, liberation is not the end of a road, it is the beginning of another road, it is our daily commitment to make freedom felt in every corner of our Municipality, let us use this day for our affirmation and dedication without moving the Municipality forward with unity, respect and honest work.
---	--

Në emër të Kuvendit të Komunës së Podujevës, ju falënderoj të gjithëve që jeni pjesë e kësaj dite të madhe. Lavdi të gjithë Dëshmorëve të Kombit, nderim të përjetshëm atyre që nuk kursyen jetën për liri që ne sot e gëzojmë. Gëzuar Dita e Çlirimit të Podujevës.	On behalf of the Municipal Assembly of Podujeva, I thank you all for being part of this great day. Glory to all the Martyrs of the Nation, eternal honor to those who did not spare their lives for the freedom that we enjoy today. Happy Podujeva Liberation Day.
---	---

2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

z.Shpejtim Buliqi, theksoi, faleminderit i nderuari Kryesues i Kuvendit, e nderuara Nënkrjetare e Komunës së Podujevës znj.Marigonë Lahu, të nderuar deputet/e të Parlamentit të Republikës së Kosovës, i nderuari Kryetar i Qytetit Ames të Shtetit të Iowa-SHBA zotëri John Haila, e nderuara zonja Karla McCollum presidente e Shogatës së Qyteteve Partnere Ndërkombëtare të Ames, i nderuar Gjeneral Major Timothy Orr, e nderuara Kryetare Paula Dierenfeld të respektuar drejtor të Drejtorive të Komunës së Podujevës dhe Asambleistë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, të nderuara Familje të Dëshmorëve, i nderuar Komandant i Zonës Operative të Llapit z.Rrustem Mustafa, të nderuar Komandant. Gjeneral dhe ish ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar përfaqësues nga Policia e Kosovës dhe përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, të nderuar mysafir nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga Qyteti Ames dhe Shteti Iowa, të nderuar Media, të nderuar përfaqësues të Shogatave të dala nga lufta, shumë i respektuar Konsull i Kosovës në Shtetin e Iowa, të dashur qytetarë të Podujevës. Sot jemi mbledhur në këtë seancë solenne për të shënuar 26 vjetorin e Çlirimit të Komunës së Podujevës. Kjo Ditë - 19 Qershori, nuk është vetëm një pikë kthese në rrugëtimin tonë për liri dhe pavarësi por është edhe një kujtesë e	z.Shpejtim Buliqi, emphasized, thank you, Honorable Speaker of the Assembly, Honorable Deputy Mayor of the Municipality of Podujeva, Mrs. Marigonë Lahu, Honorable Members of the Parliament of the Republic of Kosovo, Honorable Mayor of the City of Ames, Iowa, USA, Mr. John Haila, Honorable Mrs. Karla McCollum, President of the Association of International Partner Cities of Ames, Honorable Major General Timothy Orr, Honorable Chairperson Paula Dierenfeld, Respected Director of the Directorates of the Municipality of Podujeva and Assembly Members of the Assembly of the Municipality of Podujeva, Honorable Families of the Martyrs, Honorable Commander of the Llapi Operational Zone, Mr. Rrustem Mustafa, Honorable Commander. General and former soldier of the Kosovo Liberation Army, honored representatives from the Kosovo Police and representatives from the Kosovo Security Force, honored guests from the United States of America from Ames City and the State of Iowa, honored Media, honored representatives of Associations emerging from the war, highly respected Consul of Kosovo in the State of Iowa, dear citizens of Podujeva. Today we have gathered in this solemn session to mark the 26th anniversary of the Liberation of the Municipality of Podujeva. This Day - June 19, is not only a turning point in our journey for
---	---

2. Keynote speech by the Mayor of Podujevo Municipality

përhershme për sakrificën, qëndresën dhe guximin e atyre që luftuan për një Kosovë të lirë dhe sovranë. Me nderim të thellë ne përkulemi para veprës së Dëshmoreve të Kombit të cilët dhanë jetën për lirinë të cilën ne sot e gëzojmë. I kujtojmë me respekt e mirënjohje të veçantë kontributin e jashtëzakonshëm të ushtarëve të Zonës Operative të Llapit që përbërën një nga shtyllat kryesore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Komandantët dhe Usharët e saj që shkruan me gjak dhe sakrificë historinë tonë më të lavdishme. Kjo seancë solemne është e veçantë edhe për një arsye tjetër, sot në këtë ditë historike për Komunën tonë, ne do të nënshkruajmë Marrëveshjen e Binjakëzimit me Qytetin Ames të Shteti Iowa në SHBA, kjo Marrëveshje është një dëshmi konkrete e miqësisë së përhershme që populli i Kosovës ka me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në ditët më të vështira për popullin tonë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës qëndruan përkrah nesh, dhe sot 26 vite pas çlirimit po e forcojmë këtë aleancë përmes lidhjeve institucionale, kulturore dhe sferave tjera në mes Qytetit tonë dhe Qytetit Ames. Historia e Kosovës është e mbushur me dhimbje, sakrificë dhe krenari, shekuj me radhë populli ynë është ballafaquar me padrejtësi dhe shtypje por asnjëherë nuk ka heqë dorë nga ëndrra për liri dhe pavarësi. Liria jonë është trashëgimi e një gjenerate të tërë atdhetarësh të cilët jetën e tyre i'a falën kauzës më të shenjtë, lirisë së atdheut. Në këtë ditë solemne nuk mund të mos përmenden me nderim Komandanti Legjendar Adem Jashari dhe tërë Familjen Jashari që u flitua për të mos lejuar që kjo tokë të mbetet në robëri, po ashtu me krenari kujtojmë Zahir Pajazitin birtin e kësaj ane dhe komandantin e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i cili udhëhoqi me guxim fillimet e luftës Çlirimtare dhe që frymëzoi një popull të tërë me guximin e tij për t'u përballur me pushtuesin edhe në kushtet më të rënda.	freedom and independence but is also a permanent reminder of the sacrifice, endurance and courage of those who fought for a free and sovereign Kosovo. With deep respect we bow before the work of the Martyrs of the Nation who gave their lives for the freedom that we enjoy today. We remember with special respect and gratitude the extraordinary contribution of the soldiers of the Llap Operational Zone who constituted one of the main pillars of the Kosovo Liberation Army, its Commanders and Soldiers who wrote our most glorious history with blood and sacrifice. This solemn session is special for another reason, today on this historic day for our Municipality, we will sign the Twinning Agreement with the City of Ames, Iowa, USA, this Agreement is a concrete proof of the permanent friendship that the people of Kosovo have with the United States of America. In the most difficult days for our people, the United States of America stood by us, and today 26 years after liberation we are strengthening this alliance through institutional, cultural and other spheres of ties between our City and the City of Ames. The history of Kosovo is filled with pain, sacrifice and pride, for centuries our people have faced injustice and oppression but have never given up on the dream of freedom and independence. Our freedom is the legacy of an entire generation of patriots who gave their lives to the most sacred cause, the freedom of the homeland. On this solemn day, we cannot fail to honor the Legendary Commander Adem Jashari and the entire Jashari Family who sacrificed themselves to prevent this land from remaining in captivity. We also proudly remember Zahir Pajaziti, the son of this side and the first commander of the Kosovo Liberation Army, who courageously led the beginnings of the Liberation War and who inspired an entire people with his courage to confront the invader even in the most difficult conditions.
---	---

Me respekt të thellë kujtojmë edhe Presidentin historik Doktor Ibrahim Rugova arkitektin e pavarësisë sonë që me urtësi dhe vizionin e tij ndërtoj themelet e Shtetit të Kosovës përmes rezistencës paqësore dhe bashkëpunimit me aleatët ndërkombëtar. Në këtë ditë historike nuk mund të mos e përkujtojmë edhe Adem Demaçin simbolin e qëndresës Shqiptare i cili kaloi më shumë se 28 vite në burgjet e regjimit jugosllav, por kurrë nuk u përul e as nuk u dorëzua, ai ishte zëri i ndërgjegjes tonë kombëtare. Të gjithë këta emra të mëdhenj, së bashku me mijëra të tjerë kontribuan në forma të ndryshme, e të cilat janë burim i yni i frymëzimit. Përgjegjësia jonë e përditshme dhe amaneti që ne duhet ta mbajmë gjallë përmes veprave dhe përkushtimit për ndërtimin dhe zhvillimin e Kosovës. Të nderuar të pranishëm, sot më shumë se kurrë kemi nevojë për unitet, jemi një popull që e kemi paguar lirinë me gjakë e me të mirët tanë, prandaj kemi detyrë morale e Kombëtare që të punojmë së bashku për të ndërtuar një shtet funksional, demokratik dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Lavdi të gjithë Dëshmorëve të Kombit, respekt të përjetshëm për Familjet e tyre. Zoti e bekoftë Kosovën. Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës Rroftë miqësia e përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ju faleminderit.	With deep respect, we also remember the historic President Doctor Ibrahim Rugova, the architect of our independence, who with his wisdom and vision built the foundations of the State of Kosovo through peaceful resistance and cooperation with international allies. On this historic day, we cannot fail to remember Adem Demaçi, the symbol of Albanian resistance, who spent more than 28 years in the prisons of the Yugoslav regime, but never bowed down or surrendered; he was the voice of our national conscience. All these great names, along with thousands of others, contributed in various ways, which are our source of inspiration. Our daily responsibility and the trust that we must keep alive through our deeds and dedication to the construction and development of Kosovo. Honorable guests, today more than ever we need unity, we are a people who have paid for freedom with our blood and our best, therefore we have a moral and national duty to work together to build a functional, democratic and equal state for all citizens. Glory to all the Martyrs of the Nation, eternal respect for their Families. May God bless Kosovo. Long live the Kosovo Liberation Army Long live the eternal friendship with the United States of America. Thank you.
---	---

Kryesuesi i Kuvendit z.Hilmi Hoxha, fton për një fjalë rasti Komandantin e Zonës Operative të Llapit z.Rrustem Mustafa

The Speaker of the Assembly, Mr. Hilmi Hoxha, invites for a special speech the Commander of the Llapi Operational Zone Mr.Rrustem Mustafa,

Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shogatave të dala nga Lufta e UÇK-së

Occasional speech by the representative of the Associations emerging from the KLA War

z.Rrustem Mustafa, ish Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit, dhe në emër të tri Shogatave të dala nga Lufta, theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës z.Shpjetim Bulliqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës z.Hilmi Hoxha, Nënkrjetare e Komunës znj.Marigonë Lahu, i nderuar Kryetar i Komunës partnere me Komunën e Podujevës John Haila, zonja Karla McCollum, i nderuari Gjeneral Timoti Orr, Konsulli i Kosovës në Shtetin Iowa z.Drilon Zogaj, të nderuar asambleistë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, zyrtar të Republikës së vendit, bashkëlulftëtar të mi, urime Dita e Çlirimit të Podujevës. Është dita ku është hapë rruga dhe perspektiva për jetë dhe për liri më të mirë për çka falënderojmë fuqishëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n që dolën në krah të së mirës dhe kurre populli jonë nuk do të harrojmë ndihmën nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. I gëzohemi faktit që jemi në anën e boshit të mirë të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gëzohemi nga projektet e përbashkëta dhe atë jo vetëm në Komunën tonë për zhvillim ekonomik të mirë të kohës. Ne Shtetin tonë e konsiderojmë si projekt të përbashkët Kosovë - Amerikë, ju jemi borgjlinj tërë jetën dhe faleminderit që jeni sot me ne. Nderime për Heronjtë e vendit, nderime për të gjithë ata që japën për vendin tonë. z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, duke falënderuar parafolësit, theksoi, ju njoftoj se kjo ishte pjesa solemne me rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit të Komunës së Podujevës.	Mr. Rrustem Mustafa, former Commander of the Kosovo Liberation Army in the Llapi Operational Zone, and on behalf of the three Associations that emerged from the War, emphasized, Honorable Mayor of Podujeva Municipality Mr. Shpjetim Bulliqi, Chairman of the Municipal Assembly Mr. Hilmi Hoxha, Vice Mayor of the Municipality Ms. Marigonë Lahu, Honorable Mayor of the partner municipality with the Municipality of Podujeva John Haila, Mrs. Karla McCollum, Honorable General Timothy Orr, Consul of Kosovo in the State of Iowa Mr. Drilon Zogaj, Honorable Assembly members of the Podujeva Municipality Assembly, officials of the Republic of the country, my comrades, congratulations on the Liberation Day of Podujeva. It is the day when the path and perspective for a better life and freedom were opened, for which we strongly thank the United States of America and the NATO that came out on the side of good and our people will never forget the help from the United States of America. We are happy that we are on the side of the good axis led by the United States of America, we are happy about the joint projects and not only in our Municipality for the good economic development of the time. We consider our State as a joint project Kosovo - America, we are indebted to you all our lives and thank you for being with us today. Honors to the Heroes of the country, honors to all those who give for our country. Mr.Hilmi Hoxha, Speaker of the Assembly, thanking the speakers, emphasized, I inform you that this was the solemn part on the occasion of marking the Liberation Day of the Municipality of Podujeva.
---	---

3. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Binjakëzimit me Qytetin Ames të Shtetit Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës, i njofton të pranishmit se tani kemi ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes në mes Komunës së Podujevës dhe Qytetit Ames të Shtetit të Iowa - SHBA.

Me këtë rast lëshohet në TV monitor përmes videos ku z.John Haila, Kryetar i Qytetit Ames, i drejtohet Komunës së Podujevës dhe të pranishmëve ku njëkohësisht edhe nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

z.John Haila, Kryetar i Qytetit Ames të Shtetit të Iowa-SHBA, përmes videos, theksoi, është nderi im sot që të vendos nënshkrimin tim në Marrëveshje për të vendosur këtë marrëhenie të binjakëzimit me komunitetin tuaj.

Sot jam bashkë me Karla McCollum, e cila është Presidente e Shogatës së Qyteteve Partnere Ndërkombëtare të Ames dhe ajo do të udhëtoj në qytetin tuaj për të më përfaqësuar, ndërsa Ju nënshkruani të njëjtën marrëveshje. Ne presim me padurim mundësinë për të zhvilluar një marrëdhënie të fortë me komunitetin tuaj, të ndëtojmë mundësi arsimore dhe eventualisht të shohim shkëmbime midis të rriturve dhe të rinjve midis dy qyteteve tona. Dhe keshu me këtë, do të filloj të nënshkruaj Marrëveshjen që janë në gjuhën tonë, dhe në dy nga gjuhët tuaja. Pra, me 19 qershor, pres t'ju bashkohem virtualisht dhe të jem deshmitar i nënshkrimit të Marrëveshjes nga Kryetari juaj dhe pres me padurim të fillojmë të vendosim këtë marrëdhënie dhe komunitet që ishte caktuar në marrëveshje per të nisur procesin e ndërtimit dhe/ose binjakëzimit siç i referoheni në marrëveshje midis qyteteve tona. Pres me padurim t'ju shoh në të ardhmen e afert.

3. Signing of the Twinning Agreement with the City of Ames, Iowa, United States of America

Mr. Hilmi Hoxha, Chairman of the Podujeva Municipality Assembly, announces to the attendees that we now have the ceremony of signing the Agreement between the Municipality of Podujeva and the City of Ames, Iowa - USA.

On this occasion, a video is broadcast on the TV monitor where Mr. John Haila, Mayor of Ames, addresses the Municipality of Podujeva and the attendees, where he simultaneously signs the Cooperation Agreement.

Mr.John Haila, Mayor of Ames City, Iowa, USA, through video, emphasized, It is my honor today to sign the agreement to establish this twinning relationship with your community.

Today I am joined by Karla McCollum, who is the President of Ames International Partner City Association, and she will travel to your city to represent me as you sign this same agreement. We look forward to the opportunity to develop a strong relationship with your community, to build educational opportunities, and eventually to see exchanges between adults and youth between our two cities. And so with that, I will begin signing the agreement which is in our language, and in two of your languages. So, on June 19th, I look forward to joining you virtually and witnessing the signing of the agreement by your mayor and I look forward to beginning to establish this relationship and the committee that was designated in the agreement to begin the process of building and/or twinning as you refer to in the agreement between our cities. I look forward to seeing you in the near future.

Prat, me këtë rast z. John Haila, Kryetar i Qytetit Ames të Shtetit të Iowa-SHBA, Nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, e lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Qytetit Ames të Shtetit të Iowa-SHBA. Pas kësaj,

Po ashtu edhe Kryetari i Komunës së Podujevës z. Shpejtim Bulliqi, Nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, e lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Qytetit Ames të Shtetit të Iowa-SHBA.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, në vazhdim duke i'u drejtuar të pranishmëve, dhe përmes videos linjës drejtpërdrejt edhe Kryetari të Qytetit Ames, theksoi, është një nderë i veçantë dhe një emocion i madh për mua dhe për qytetarët e Komunës së Podujevës që sot nënshkruam Marrëveshjen e Binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetit Ames të Shtetit të Iowa-SHBA. Ky binjakëzim është një urë e re miqësie, bashkëpunimi dhe përkushtimi të ndërsjellë për të ardhmen në horizonte të reja për dy qytetet tona.

